

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vuçiç i pakënaqur me vendimin e Hagës: Mos festoni ende
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/16/vucic-i-pakenaqur-me-vendimin-e-hages-mos-festoni-ende/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:24:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:18:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9a209514cfb224ca59a5caefed5e32592a3afc93e383f85a062496ea67b2a1d2
TEKSTI	b2ec5daacbbd78b66936f8e78eb573da2e9f249e518aea3d27f6335bf6eb1983
PAMJA	3024b005598bf6366e7c915fd51c3d81b4bb2b32d6953e30cca2bbdc4ea3bdc2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5ca0292e99f4be96c90afae964d263a4273e4c1ef16d22aa17d81809ac0f3186
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5ca0292e99f4be96c90afae964d263a4273e4c1ef16d22aa17d81809ac0f3186>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > Lajmet e Dites

Vuçiç i pakënaqur me vendimin e Hagës: Mos festoni ende

19:18 : 16/09/2026 në Lajmet e Dites, RAJONI



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, duke e komentuar aktgjykimin në një konferencë për mediat.

Pavarësisht dënimeve që në total arrijnë në 81 vite burgim, Vuçiç tha se vendimi nuk përputhet me atë që Serbia ka pretenduar prej vitesh lidhur me krimet e kryera gjatë dhe pas luftës në Kosovë.

Gjatë konferencës, presidenti serb analizoi pjesë të ndryshme të vendimit dhe u ndal te akuzat për krime kundër njerëzimit. Sipas tij, trupi gjyqësor nuk ka konstatuar sulme sistematike ndaj popullsisë civile dhe ka rrëzuar të gjashta pikat e aktakuzës që lidhen me këtë kategori krimesh.

“Është e rëndësishme të theksoj se trupi gjyqësor nuk konstatoi sulme sistematike kundër popullsisë civile. Nuk deshën ta rrënonin kredibilitetin e UÇK-së. Çfarë nuk përfshihet në këtë vendim? Krimet kundër njerëzimit. Të gjashta pikat e aktakuzës u hodhën poshtë”, deklaroi Vuçiç.

Ai pretendoi gjithashtu se në vendim nuk janë marrë në konsideratë krime të kryera ndaj serbëve pas përfundimit të luftës, duke përmendur edhe pretendimet e njohura lidhur me të ashtuquajturën “Shtëpia e Verdhë”.

Lexo edhe:

[Nis mbledhja e nënshkrimeve nga deputetët për zhbërjen e Gjykatës Speciale](#)[Turpi ka emër: Gjykata e Hagës dhe të marrët politikanë](#)

Në konferencë, Vuçiç shfaqti fotografi që, sipas tij, lidhen me viktimat serbe dhe argumentoi se për këto raste nuk është vendosur përgjegjësi penale.

“Mund t’ju tregoj vetëm këtë fotografi, që ta shihni se çfarë masakra është kryer dhe, siç e shihni, as për këtë krim askush nuk është përgjegjës. Kemi edhe shumë fotografi të tjera. Nuk janë marrë në konsideratë”, u shpreh ai.

TË GJITHA

**Vuçiç i pakënaqur me vendimin e Hagës: Mos festoni ende**

19:18 : 16/09/2026

**Të shtënat me armë në Durrës, kush është avokati i plagosur /EMRI**

19:13 : 16/09/2026

**Arrestohet kushëriri i Ergys Agasit, Eno Agasi**

19:09 : 16/09/2026

**Botoxi kontrabandë/ Dritan Gremi merret i i pandehur, Skerdi Faries i pushohet çështja**

18:59 : 16/09/2026

**Të shtënat në Durrës, policia: 52-vjeçari plagoset në dorë, autori në kërkim**

18:53 : 16/09/2026

**Bie puna part-time në Shqipëri, diferencë e madhe mes grave dhe burrave**

18:39 : 16/09/2026

**Nis mbledhja e nënshkrimeve nga deputetët për zhbërjen e Gjykatës Speciale**

18:31 : 16/09/2026

Në fund, presidenti serb bëri thirrje për të mos e parë vendimin me eufori, duke theksuar se procesi gjyqësor nuk ka përfunduar ende dhe se vendimi mund të ankimohet në instanca të tjera.

“Ne nuk kemi arsye as të gëzohemi, as të pikëllohemi. Edhe nëse vendimi konfirmohet, ekziston edhe një instancë e tretë. Prandaj nuk duhet ta presim këtë vendim me eufori, por të jemi të duruar”, deklaroi Vuçiç.

Etiketa: gjykata speciale hage uck vendim Vucic

Lajme të lidhura



Nis mbledhja e nënshkrimeve nga deputetët për zhbërjen e Gjykatës Speciale

18:31 : 16/09/2026



Turpi ka emër: Gjykata e Hagës dhe të marrët politikanë

18:19 : 16/09/2026



“Jo në emrin tim”/ Reagimet e artistëve shqiptarë pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së

18:11 : 16/09/2026



Përplasjet në Hagë/ Policia holandeze: 2 protestues në pranga, 1 polic i lënduar

18:03 : 16/09/2026



Detajet e verdiktit për ish-krerët e UÇK-së: Çka konstatoi trupi gjyqësor?

16:54 : 16/09/2026



Dënimi në Hagë/ Thyhen xhamat e bazës së EULEX-it, bllokohet rruga Prishtinë–Fushë Kosovë

16:16 : 16/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

